



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-21-0174

Në ankesën e

Paditësja/Ankuesja

K B Beograd, Serbi, e përfaqësuar nga A nga Beogradi- përfaqësuesi, avokati **Dobrica Lazic**, rruga "Car Lazari", pn Graçanicë.

Kundër:

E paditura

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga, Gjyqtari Kryesues, Ilmi Bajrami, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7054, të datës 18 shkurt 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-7054, i datës 18 shkurt 2021.**
- 3. Paditësit i kthehet depozita në shumë prej 10.000 euro, e cila ishte caktuar të deponohet në DHPGJS, në bazë të Aktvendimit të Kolegjit**

të Apelit AC-I-15-0058 të datës 12 qershor 2015. Depozita kthehet në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij Aktgjykimi.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me datë 26 dhjetor 2012, paditësja ka dorëzuar një padi në DHPGJS, dhe ka kërkuar të anulohet vendimi për shitje në Valën e 56 të privatizimit të asetëve të B Th“B”, nga ana e të paditurës, dhe vërtetim të së drejtës të pronësisë, ose kompensimin material në shumë prej 8.004.777euro, (tetë milion e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) me ç’ rast ka kërkuar edhe lëshimin e një urdhri paraprak gjyqësorë. Kjo lëndë regjistrohet me numër C-III-12-2033, dhe është lëndë ende aktive në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Me datë 28 shkurt 2013, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin C-III-12-2033 e refuzon si të pabazuar kërkesën e paditësit për lëshimin e Urdhrit paraprak gjyqësorë.

Me datë 20 shtator 2013, AKP-ja e dorëzoi mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Tutje AKP-ja konsideron se në bazë të nenit 5 të Ligjit të AKP-së janë përcaktuar kërkesat ligjore të cilat nëse janë plotësuar mund të konsiderohet për një transformim ligjor të NSH-së, por që në këtë rast, AKP-ja konsideron se paditësi ka dështuar të ofroj prova që është kryer një transformim ligjor dhe i rregullt i NSH Banka Themelore “Bankos”. AKP-ja pohon se kapitali shoqëror nuk është vlerësuar para se të merret vendimi për transformim, pastaj nuk ka dëshmi të pagesave të aksioneve të brendshme, mungojnë certifikatat e pagesave të cilat tregojnë emrin e kontribuesit, certifikatat për aksione të brendshme janë të pa plotësuar dhe nuk përmbajnë detajet e nevojshme të specifikuar në Ligjin mbi kapitalin shoqëror, mungon gjendja financiare në llogaritje të duhura mbi transformimin e kapitalit, nuk ka shënime mbi kontabilitetin (gjendja e bilancit-pasqyra financiare) që tregojnë se ka ekzistuar një kontabilitet dy nivelesh, mungojnë të dhënat e sakta për pjesëmarrjen e punëtorëve gjatë blerjes së aksioneve, dhe të

metat e tjera të cilat e bëjnë këtë transformim të pa vlefshëm. Tutje AKP-ja pohon se Bordi i Drejtorëve me dokumentin SDR 0760 ka përcaktuar se "Bankos" me seli në Prishtinë është ndërmarrje shoqërore dhe është nën përgjegjësin ligjore menaxhuese të AKP-së në bazë të Ligjit të AKP-së. AKP-ja pohon se deklarimet e paditësit se kemi të bëjmë me shoqëri aksionare nuk janë të bazuara dhe bie në kundërshtim me dokumentin SDR, e aprovuar nga AKM-ja në vitin 2005, duke pohuar se kemi të bëjmë me një entitet juridiko- financiar i bazuar në kapitalin në pronësi shoqërore, sipas Ligjit mbi kushtet dhe sistemin bankar financiar të vitit 1977 (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/2) dhe neni 13 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja po ashtu pohon se asetet e kësaj Banke evidentohen në regjistrin kadastral si pronë shoqërore.

Me datë 01 gusht 2014, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur ndaj Aktvendimit të cekur të Kolegjit të Specializuar, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-13-0034 e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar, dhe refuzon ankesën si të pabazuar me arsyetimin se asetet e pretenduara nga paditësi ishin të regjistruara në librat kadastral si pronë shoqërore dhe se nuk ishte asnjë dëshmi se kishte përfunduar transformimi i pronës tek paditësi.

Me datë 21 nëntor 2014, paditësi e dorëzon në DHPGJS një padi të re me të cilën kërkon që të anulohet vendimi i Bordit të AKP-së i datës 07.05.2014 për likuidimin e NSH-Banka Themelore 'Bankos', dhe ka kërkuar të pezullohet likuidimi i kësaj ndërmarrje i filluar nga data 16.06.2014. Së bashku me këtë padi paditësi parashton edhe një kërkesë që të lëshohet Urdhri paraprak gjyqësorë dhe të ndalohet AKP-ja që ti shes asetet e "K B dd" Beograd në falimentim e cila do të bëhej në bazë të vendimit të AKP-së të datës 07.05.2014 për likuidimin e NSH-Banka Themelore "Bankos". Kjo lëndë regjistrohet me numër të ri C-IV-14-7054.

Me datë 20 shkurt 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-7054 e ka hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën e paditësit për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësorë. Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se paditësja nuk ka

ofruar argumente ose prova të reja në mbështetje të kërkesës së saj. Kjo kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor është identike me atë të prezantuar në shkresat e lëndës C-III-12-2033 dhe në ankesën e saj në lëndën AC-I-13-0034, sa i përket palëve, rrethanave faktike dhe kërkesave. Kolegji i Specializuar ka vlerësuar se urdhri paraprak gjyqësor nuk është res judicata sa i përket padisë kryesore, ose ndaj një kërkesë tjetër për urdhër paraprak gjyqësor nëse rrethanat faktike kanë ndryshuar.

Me datë 20 mars 2015, paditësja ka dorëzuar një ankesë të afatshme ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-IV-14-7054 të datës 20 shkurt 2015, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër në ankesë paditësja pretendon se Aktvendimi i ankimuar është i parregullt dhe jo ligjor dhe i marrë për ti arsyetuar veprimet e AKP-së e cila sipas saj në mënyrë të pa autorizuar po e shet pronën e pronarit ligjor pa pëlqimin e saj. Paditësja pretendon në ankesë se refuzimi i masës së përkohshme që ka ndodhur paraprakisht nuk paraqet çështje të gjykuar. Sipas paditëses Aktvendimi mbi refuzimin e masës së përkohshme C-III-12-2033 i datës 28.02.2013 nuk është pengesë procedurale që Gjykata të vendosë masën e kërkuar të përkohshme në lëndën C-IV-14-7054. Gjykata mund sërish ta refuzoj kërkesën e paditësit ose ta aprovojë atë por nuk mund ta hedh poshtë kërkesën me arsyetimin se bëhet fjalë për çështjen e gjykuar. Vendimi i Shkallës së I-rë mbi refuzimin e masës së përkohshme të kërkuar nuk e shkurton të drejtën e paditësit që përsëri të kërkojë dhënien e masës së përkohshme në qoftë se paraqiten rrethana të cilat tregojnë nevojën e dhënies së masës së përkohshme për të penguar humbjen e të drejtës së kërkuar. Paditësi në ankesë pohon se vendimet e kontestuar të AKP-se nuk kanë qenë identike, derisa vendimi i parë ka qenë për shitjen e një pjese të pasurisë së paditëses ndërsa vendimi i dytë ka të bëjë me shitjen e paditësit si person juridik, dhe këto vendime janë marrë në kohë të ndryshme. Andaj Paditësja kërkon që të anulohet Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar, të jepet masa e përkohshme e kërkuar dhe të ndalohet e paditura që ti shes asetet e kontestuara deri në zgjidhjen e meritave të padisë.

Me datë 08 prill 2015, e paditura paraqet përgjigjen në ankesë me të cilën kërkon që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në përgjigjen në ankesë AKP-ja pohon se qëndron pranë të gjitha kundërshtimeve, pretendimeve dhe parashtresave të paraqitura deri më tani në Dhomën e Posaçme lidhur me këtë çështje juridike. E paditura pohon se nga provat e prezantuara deri më tani nga ana e paditëses nuk janë vërtetuar pretendimet pronësore që i ka paditësja ndaj NSH-së Banka Themelore "Bankos". Ankesa e paraqitur ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar nuk përmban asnjë fakt të ri nga i cili duhet të ndryshonte rrjedha e procedurës ose gjendja faktike e çështjes. AKP-ja pohon se duke u bazuar në mandatin e saj ligjor që e ka sipas ligjit për AKP-në nr. 04/L-034, e ka analizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse statusin e kësaj NSH-je, historikun e saj, ndryshimin e kapitalit, mënyrën e organizimit të qeverisjes të këtij entiteti dhe ka konstatuar se kemi të bëjmë me një subjekt juridik i cili është qeverisur mbi bazë të kapitalit në pronësi shoqërore. Këtë pohim AKP-ja e mbështet me provën të cilën tashmë e ka sjellë në shkresat e lëndës C-III-12-2033 dhe AC-I-13-0034, SDR 0760 i NSH "Bankos" me seli në Prishtinë i datës 22.07.2005. AKP-ja pohon në përgjigjen në ankesë se ky SDR është dorëzuar edhe më herët sepse e njëjta ankesë është përsëritur disa herë. Sipas AKP-së paditësja për nga statusi i saj pronësor rezulton se është në pronësi shoqërore dhe si e tillë ajo bie nën juridiksionin e AKP-së sipas nenit 5 të Ligjit për AKP-në. Andaj sipas AKP-së janë të pabazuara deklaratimet e paditëses se kemi të bëjmë me shoqëri aksionare e jo me pronë shoqërore. Prona dhe tipi i saj është kushti kryesor që e përcakton kompetencën-juridiksionin e AKP-së lidhur me asetet e NSH "Bankos" me seli në Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" nr. 49. Asetet e kësaj ndërmarrje shoqërore evidentohen si asete në pronësi shoqërore sipas listës poseduese nr. 10978 në Prishtinë. AKP-ja në përgjigjen në ankesë pohon se ndryshimi i pretenduar pronësorë nuk ka mundur të ndodhë për faktin se sipas saj nuk janë respektuar procedurat ligjore për transformimin pronësorë dhe realisht pasi një gjë e tillë nuk është bërë edhe bartja në zyrën Komunale Kadastrale të Prishtinës dhe të tjerat, nuk ka ndodh, dhe për këto arsye prona udhëhiqet në emër të pronarit legjitim si pronë shoqërore. AKP-ja pohon se nuk ka kushte ligjore në bazë të nenit 55.1 të Shtojcës së LDHP-së të jepet masa e përkohshme e kërkuar nga paditësi.

Me datë 12 qershor 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJS me Aktvendimin AC-I-15-0058 ka vendosur që me pikën 1 të dispozitivit, ankesa e paditëses është e bazuar, me pikën 2 të dispozitivit është anuluar Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar, C-IV-14-7054, i datës 20 shkurt 2015, me pikën 3 të dispozitivit është caktuar, masa e përkohshme dhe i ndalohet të paditurës ti shes asetet "K B D", Beograd e cila është në procedurë të likuidimit, deri sa të zgjidhet në merita padia me një vendim gjyqësorë të formës së prerë, dhe me pikën 4 të dispozitivit është obliguar, paditësi që të deponojë në DHPGJS shumën prej 10.000 euro, për të siguruar kompensimin e shpenzimeve dhe dëmit që mund të pësojë e paditura për shkak të masës së përkohshme, në rast se nuk del i suksesshëm në merita të padisë. Kolegji i Apelit në këtë pikë të dispozitivit ka vendosur që në rast se paditësi nuk e deponon shumën e cekur në afati prej 15 ditësh nga dita kur ai e pranon Aktvendimin, masa e përkohshme e dhënë nuk do të prodhojë efekte juridike. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se paditësi në padinë e fundit të dorëzuar me 21 nëntor 2014, po kërkon anulimin e vendimit të Bordit të AKP-së të datës 07.05.2014 me të cilën NSH Banka Themelore "Bankos" është vënë nën likuidim dhe kërkon që ti mbrohen asetet e pretenduara të këtij entiteti bankar, nga shitja që do të bëhet përmes procedurës së likuidimit. Në fakt është një kërkesë pronësore për ti mbrojtur të drejtat e pretenduara pronësore që i përkasin këtij entiteti bankar. Edhe në padinë paraprake të dorëzuar në Dhomën e Posaçme me 26 dhjetor 2012, kërkohej anulimi i vendimit për shitje të këtyre aseteve, në valën e 56 të privatizimit dhe kërkohej vërtetimi i të drejtës së pronësisë në këto asete ose kompensimi material në një shumë prej 8.004.777euro. Këto padi janë në pritje për tu zgjidhur dhe çështja kruciale në këto lëndë është vërtetimi i faktit se a ka ndodhur një transformim pronësor ligjor dhe jo diskriminues, i pretenduar nga paditësja se tashmë ka ndodhë, do të thotë duhet të vërtetohet titullari ligjor i këtyre aseteve. Kjo është çështje e meritave të padisë. Siç ka konstatuar saktë Kolegji i Specializuar në lëndën C-III-12-2033, paditësja ka dështuar të sjellë prova për të vërtetuar se janë plotësuar kriteret ligjore për të dhënë masën e përkohshme të kërkuar. Mirëpo kjo nuk qëndron edhe sa i përket kërkesës për masë të përkohshme në lëndën C-IV-14-7054. Në këtë lëndë paditësja deri më tani ka sjellë disa prova për të vërtetuar probabilitetin se ka qenë i suksesshëm transformimi i NSH Banka Themelore "Bankos"

në Shoqëri Aksionare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se ekziston e drejta që e pretendon. E paditura ka arrite të sjellë prova lidhur me këtë entitet bankar ndërsa asetet e kësaj Banke aktualisht janë të evidentuara në regjistrat kadastral si pronë shoqërore. Paditësi së bashku me padi ka sjellë disa prova që vërtetojnë një shkallë të probabilitetit për të drejtën që e pretendon siç janë dëshmitë vijuese: Aktvendimin e Bankës së Jugosllavisë nr.148, datë 20.06.1990 për lejimin e themelimit të Bankës së Kosovës si shoqëri aksionare, Vendimi për themelimin e Bankës së Kosovës si shoqëri aksionare të datës 28.06.1990, Aktvendimin për regjistrim si shoqëri aksionare të kësaj banke në regjistrin e Gjykatës ekonomike të Qarkut në Prishtinë të datës 20.07.1990, e dëshmi tjera që i përkasin procedurës së regjistrimit. Mund të konstatohet se ka një shkallë të caktuar të probabilitetit për të drejtën që pretendohet që ka arrite paditësi të vërtetojë, kur e ka bërë kërkesën për masë të përkohshme.

Me datë 10 korrik 2015, paditësi e deponoi në xhirollogarinë e Gjykatës në Raifaisen Bank depozitën në shumë prej 10.000 euro, e cila ishte caktuar me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0058 të datës 12 qershor 2015.

Me datë 03 dhjetor 2020, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS e mbajti një seancë dëgjimore mbi padinë, por e cila nuk kishte përfunduar.

Me datë 09 dhjetor 2020, AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS në të cilën ajo i mbron pretendimet e veta që ndërlidhen me procesin e transformimit të Bankës Themelore "Bankos" në likuidim.

Me datë 11 dhjetor 2020, mbahet seanca tjetër dëgjimore lidhur me padinë. Në bazë të proces verbalit të kësaj seance shihet se te dy palët në këtë seancë i kanë mbrojtur pretendimet e tyre të paraqitura deri më tani në këtë procedurë. Në bazë të këtij proces verbal shihet se të dy palët janë obliguar ta paraqesin fjalën përfundimtare me shkrim në Gjykatë.

Me datë 28 dhjetor 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS fjalën përfundimtare me shkrim. Në fjalën përfundimtare AKP-ja prapë i kundërshton pretendimet e padisë

dhe të gjitha pretendimet e tjera të parashtruara në këtë procedurë duke e konsideruar se personat të pa autorizuar të njësisë- filialin e NSH-së "Bankos" me seli në Beograd në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa autorizuar e kanë transformuar njësinë "Bankos" SH.A, dhe në këtë mënyrë e kanë përvetësuar – regjistruar pronën në mënyrë të kundërligjshme. Bashkë me fjalën përfundimtare AKP-ja ka bashkangjitur vendime të Kuvendit të Republikës së Serbisë të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, nr. 43, me 07 gusht 1990, që ndërlidhen me NSH Banka Themelore "Bankos".

Me datë 29 dhjetor 2020, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS në të cilën ai i mbron pretendimet e deri tanishme të tij të paraqitura në padi dhe gjatë procedurës në shkallën e I-rë. Bashkë me këtë parashtresë ai dorëzon dokumentacion të njëjtë lidhur me procesin e zhvilluar të transformimit të NSH "Bankos" në SH.A.

Me datë 30 dhjetor 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS, fjalën përfundimtare me shkrim lidhur me padinë. Në fjalën përfundimtare paditësi ka përshkruar rrjedhën e deri tanishme të procedurës dhe procesin e pretenduar të transformimit, duke pohuar se mbetet pranë padisë dhe ka kërkuar nga Gjykata të aprovohet padia në tërësi si e bazuar, dhe të anulohet vendimi i Bordit të AKP-së i datës 07 maj 2014, mbi likuidimin e NSH – Banka Themelore "Bankos", në Prishtinë, si dhe të vendos të pezulloj likuidimin e kësaj ndërmarrje të filluar me 16 qershor 2014.

Me datë 18 shkurt 2021, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me pikën **I** të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-14-7054, e refuzon padinë e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e Bordit të AKP-së të datës 07 maj 2014, për likuidimin e NSH-së Banka Themelore "Bankos" si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Me pikën e **II** të dispozitivit të Aktgjykimit, Kolegji i Shkallës së I-rë ka vendosur që nga data kur ky Aktgjykim të bëhet i formës së prerë, Aktvendimi i Kolegjit të Apelit i datës 12 qershor 2015, me të cilin ishte caktuar masa e sigurisë për të pezulluar likuidimin e NSH-së Banka Themelore "Bankos", dhe për të ndaluar AKP-në për çdo menagjim, deponim dhe shitje të mëtejme të pasurive të Bankës së Kosovës SH.A Beograd, në

falimentim, nuk do të prodhon më efekte juridike. Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk është kontestuese në mes palëve, se Banka e Kosovës (tani në likuidim), ka qenë Ndërmarrje Shoqërore para vitit 1990, por kontestuese mbetet fakti i transformimit ligjor dhe statusi aktual i ndërmarrjes që është objekt i këtij kontesti, dhe kësisoj paditësi pretendon se Aktvendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP i datës 07 maj 2014, për likuidimin e Ndërmarrjes Shoqërore Banka e Themelore "Bankos", është i paligjshëm. Tutje shkalla e I-rë konstaton se në këtë çështje, kontestuese në mes palëve është statusi i Ndërmarrjes "Banka e Kosovës", se a është Ndërmarrje Shoqërore me kapital shoqëror, apo është Shoqëri Aksionare. Paditësi pretendon se është themeluar si shoqëri aksionare dhe se transformimi është kryer në përputhje me Ligjin për Bankat dhe Organizatat e tjera Financiare (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së) nr. 10/89 i dt. 17.02.1989. Ndërsa e paditura pretendon se kjo ndërmarrje e ka statusin e Ndërmarrjes Shoqërore me kapital shoqëror dhe se transformimi i bërë nuk mund të konsiderohet valid, për arsyet e jo ligjshmërisë së transferimit dhe diskriminimit gjatë procesit së transformimit. Shkalla e I-rë konstaton se Aktvendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP i datës 07 maj 2014, për likuidimin e Ndërmarrjes Shoqërore Banka e Themelore "Bankos", të cilin pala paditëse e ka atakuar me padi, është i ligjshëm, pasi që ndërmarrja e lartcekur bie nën administrimin e AKP-së, dhe e njëjta ka të drejtë të administrojë asetet e kësaj NSH-je, si dhe ka pasur të drejtë që të vendos lidhur me futjen e saj në likuidim. Tutje shkalla e I-rë konstaton se transformimi i pretenduar i ndërmarrjes nga paditësi, nga ndërmarrje shoqërore në shoqëri aksionare, ka ndodhur në vitin 1990 dhe në bazë të Ligjit mbi AKP-së dhe Rregulloreve pararendëse të UNMIK-ut, një transformim i tillë mund të pranohet vetëm nëse është bërë në mënyrë ligjore, dhe në mënyrë jo diskriminuese. Gjykata duke marrë në shqyrtim argumentimin e dy çështjeve kryesore në këtë rast, si ligjshmërinë e transformimit dhe jo diskriminimin gjatë procesit të transferimit të statusit të kësaj ndërmarrje, vie në përfundim se një transformim i tillë nuk është bërë duke i respektuar dispozitat ligjore, dhe kësisoj një transformim i tillë, as atëherë por as tani, nuk mund të prodhojë efekte juridike. Në rastin konkret gjykata vlerëson se për ligjshmërinë e transformimit të një ndërmarrje, me rendësi vendimtare, ishin edhe përmbushja e kushteve tjera të transformimit siç ishin vlerësimi i kapitalit shoqëror të ndërmarrjes, vendimi për lëshimin dhe ndarjen e

aksioneve të brendshme, dëshmi për pagesat e aksioneve nga aksionarët, të cilat kushte nuk ishin plotësuar, apo pala paditëse ka dështuar që t'i provojë gjatë procedurave me shkrim dhe në seancën dëgjimore. Statuti Themeltar dhe i tërë dokumentacioni i Subjektit Banka e Kosovës, paraqesin bazën ligjore për të konkluduar se ky subjekt është në pronësi shoqërore, dhe duhet të trajtohet si Ndërmarrje Shoqërore. Gjykata vlerëson se, shumica e transformimeve të bëra, veçanërisht pas datës 22 mars 1989 janë të pabazuara në ligjet pozitive dhe në kundërshtim me rendin juridik, kushtetues, pasi që në atë kohë vetëm se ishin të instaluar masat e dhunshme në institucionet publike dhe ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Procedurat e ndërmarrja për transformimin e subjektit në fjalë nga Ndërmarrja Shoqërore në Shoqëri Aksionare janë zhvilluar pas abrogimit të autonomisë së ish KSAK-së dhe gjatë instalimit të ligjeve diskriminuese nga Republika e Serbisë. Po ashtu, gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i palës paditëse se transformimi ligjor i ndërmarrjes nuk u shoqërua me ndonjë diskriminim mbi bazë kombëtare dhe masat e përkohshme dhe procedurat pasuese të falimentimit u futën pas ndryshimit të statusit, d.m.th. pas transformimit të ndërmarrjes dhe themelimit të saj si një shoqëri aksionare. Në kohën kur pretendohet se është ndërruar statusi i ndërmarrjes, përkatësisht në vitin 1990, në institucionet dhe ndërmarrjet shoqërore kanë qenë të instaluar masat e dhunshme dhe shumica e punëtorëve të nacionalitet shqiptar iu është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të dhunshme dhe pa dëshirën e tyre. Andaj në atë kohë, nuk ka mundur të jetë një transferim ligjor i ndërmarrjes dhe jo diskriminues, përderisa punëtorët e nacionalitetit shqiptar nuk kanë marrë pjesë në transferim dhe nuk është respektuar vullneti i tyre. Sipas rregullave të përgjithshme për barrën e të provuarit, pala duhet të dëshmojë faktet me të cilat e mbështet padinë e saj, (neni 35.2.4 dhe 42.3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme). Në bazë të këtyre rregullave paditësi do të duhej të dëshmonte me prova relevante, të gjitha fazat e procesit të transformimit si dhe bazën ligjore të këtij transformimi, gjë që në rastin konkret ka dështuar që të provojë një gjë të tillë.

Me datë 18 mars 2021, paditësi e dorëzoi përmes postës në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-7054, të datës 18 shkurt

2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka shkelur rregullat e procedurës, pasi që përgjigjja në padi e të paditurit nuk i është dorëzuar atij në mënyrën dhe procedurën e paraparë me LDHP-në dhe LPK-në, duke shkelur të drejtën e tij për shqyrtim para Gjykatës. Tutje paditësi pohon që në seancën e mbajtur me 11 dhjetor 2020, Kolegji i Shkallës së I-rë ka marrë vendim duke ia refuzuar atij kërkesën që ti jepet afat shtesë për tu deklaruar në pohimet e palës së paditur të cilat pohime ai i ka dëgjuar për herë të parë në këtë seancë, dhe me këtë ai pohon se është shkelur rregulla procedurale e nenit 7.3 të LPK-së, si dhe nenit 6 i Konventës mbi të Drejta dhe Liri të Njeriut. Tutje paditësi pretendon se Gjykata e Shkallës së I-rë e ka treguar seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa paraprakisht nuk e ka përfunduar procedurën e paraparë me shkrim. Paditësi pretendon se Gjykata përdonjë bazë është thirrë në nenin 38 të LDHP-së duke konstatuar se Gjykata të dyja palëve u ka dhënë mundësinë të paraqesin përgjigje dhe kundër përgjigje gjatë rrjedhës së seancës, duke pretenduar se me këto veprime, Gjykata e Shkallës së I-rë i ka shkelur nenet 35 deri 40 të LDHP-së. Paditësi pretendon se vetëm pas përfundimit të procedurës me shkrim Gjykata mund të tregoj seancën dëgjimore. Paditësi pretendon se për shkak të këtyre shkeljeve procedurale Aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet. Tutje paditësi pohon se Gjykata në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar ka vendosur që vendimi i organit të likuidimit i datës 07 maj 2014, për likuidimin e NSH Banka Themelore "Bankos", konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa kjo bankë ndaj të cilës zbatohet procedura e likuidimit, nuk ekziston pasi që ajo Bankë ka pushuar punën me datë 30.06.1990. Paditësi pohon se Banka Themelore "Bankos" ka qenë njëra nga Bankat Themelore në përbërje të Bankës së Bashkuar të Kosovës "Bankos" e cila edhe ishte regjistruar në regjistrin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me datë 09.03.1987, në bazë të Aktvendimit FI.208/87. Paditësi pretendon se në bazë të nenit 80 të Ligjit mbi bankat dhe organizatat tjera financiare ishte e paraparë që Bankat ekzistuese mund të vazhdojnë punën sipas dispozitave të Ligjit mbi Bankat Themelore dhe sistemin kreditor, dhe pushimi i punës me fuqinë e ligjit ka ndodhë dhe në bazë të ligjit edhe

është çregjistruare nga regjistri i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me datë 20.07.1990, ku si trashëgimtar i saj në regjistër është regjistruar "Kosovska Banka dd". Tutje në ankesë paditësi pa pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë në bazë të cilës provë ka ardhë në konkluzionin që transformimi i "Kosovska Banke dd" nuk është zbatuar në pajtim me ligjin, që me gjasë Gjykata as që e ka lexuar Ligjin mbi Bankat dhe Organizatat e tjera financiare (Gazeta Zyrtare e RSFJ)nr10/89, 40/89, 87/89 dhe 18/90, dhe as nuk i ka marrë për bazë provat të cilat paditësi i ka dorëzuar në DHPGJS. Paditësi në ankesë pretendon se transformimi i "Kosovska Bankka dd" është bërë në pajtim me Ligjin mbi Bankat dhe Organizatat e tjera financiare. Paditësi pohon se në Aktgjykimin e ankimuar i gabuar është konkluzioni për transformimin e NSH-së si shoqëri aksionare. Ai pohon se Banka si shoqëri aksionare është formuar në vitin 1991 në pajtim me dispozitat ligjore, ndërsa ndaj paditësit me datë 13.12.1990, është hapë procedura e falimentimit, ndërsa transformimi i këtyre bankave as që ka mund të bëhet. Paditësi pretendon se Gjykata nuk i ka vërtetuar faktet e rëndësishme për të vendosur në mënyrë të ligjshme në këtë lëndë. Ai pohon se ka ofruar në shkresat e lëndës vendimin e Bankës Popullore të Jugosllavisë Obr148 të datës 22 qershor 1990, për marrjen e lejes në pajtim me dispozitat ligjore, dhe pastaj pas marrjes së kësaj leje për themelimin e Bankës, me 28 qershor 1990 mbahet Kuvendi Themelues i "Kosovska Bankke dd", në të cilën është marrë vendimi për themelimin e "Kosovska Banka dd" dhe gjithë materiali nga ky Kuvend themelues është në shkresat e lëndës. Paditësi pretendon se transformimi dhe themelimi i "Kosovska Banka" si shoqëri aksionare është bërë në pajtim me procedurat dhe kushtet e Ligjit për Bankat dhe organizatat e tjera financiare. Paditësi pretendon si është e mundur që një transformim i kryer me këtë ligj të vlerësohet nga Gjykata si transformim diskriminues, pasi që ky ligj është aplikuar në tërë territorin e RSFJ-së. Paditësi pretendon se Gjykata nuk ka pas asnjë provë për diskriminim e pohuar të ish punëtorëve të Bankës sipas bazës nacionale, si para ashtu edhe gjatë procedurës së themelimit të "Kosovska Banke dd".

Me datë 14 maj 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se Aktgjykimi i Shkallës së I-rë është i bazuar në ligj dhe në prova, dhe se ky Aktgjykim duhet të vërtetohet nga Kolegji i

Apelit. Tutje AKP-ja pohon se pretendimet e veta dhe argumentet ligjore në mënyrë të mjaftueshme i ka qartësuar në mbrojtjen në padi dhe në procedurat e mëvonshme, andaj përsëritja e këtyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa i e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegji të Shkallës së I-rë, është i sakt në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 26 dhjetor 2012, e ka dorëzuar një padi në DHPGJS dhe ka kërkuar të anulohet vendimi për shitjen në valën e 56 të privatizimit të aseteve të Bankës Themelore "Bankos", si dhe të vërtetohet e drejta e pronësisë në këto asete, ose paditësi të kompensohet me një shumë prej 8.004.77,00 euro. Kjo padi në DHPGJS është regjistruar me numër C-III-12-2033, dhe kjo lëndë është ende aktive në Shkallën e I-rë të DHPGJS.

Kolegji i Apelit vëren po ashtu se paditësi edhe me datën 21 nëntor 2014, e ka dorëzuar një padi tjetër në DHPGJS, me të cilën ai kërkon që të anulohet vendimi i Bordit të AKP-së i datës 07 maj 2014, për likuidimin e NSH-Banka Themelore "Bankos", dhe ka kërkuar po ashtu të pezullohet likuidimi i kësaj ndërmarrje, e cila kishte filluar nga data 16.06.2014. Kjo padi e re në DHPGJS është regjistruar me numër C-IV-14-7054, dhe në vazhdim do të jetë objekt i vlerësimi nga ana e Kolegjit të Apelit, pasi që kjo padi edhe ishte objekt i Aktgjykimit të ankimuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar ka vendosur lidhur me padinë e dytë, duke refuzuar këtë padi si të pa bazuar, dhe duke vërtetuar vendimin e Bordit të AKP-së për likuidimin e NSH Banka Themelore "Bankos" të datës 07 maj 2014, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë me këtë Aktgjykim ka vendosur që masa e sigurisë e cila ishte caktuar më herët me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0058 të datës 12 qershor 2015, nuk do të prodhon më efekte ligjore, pasi që ky Aktgjykim të bëhet i plotëfuqishëm.

Kolegji i Apelit vlerëson se çështja themelore në këtë lëndë është, nëse kapitali i NSH Banka Themelore "Bankos" është transformuar në mënyrë të ligjshme nga pronësia shoqërore, në atë private.

Ligjet në fuqi:

Në këtë lëndë statusore zbatohen ligjet e miratuara nga tre Ligjvënës të ndryshëm:

- Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – AKP (Ligji nr. 04/L-034). Ky ligj i përcakton rregullat dhe kushtet që një transformim të njihet si i ligjshëm dhe i vlefshëm.
- Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë. Kjo Rregullore do t'i plotësojë dispozitat e përcaktuara në nenin 1.27 dhe nenin 5.4.1 të Ligjit për Agjencinë e Privatizimit dhe ndihmon në identifikimin e ligjit specifik për transformimin i cili është dashtë të respektohej nga paditësi. Në të vërtetë, neni 1.27 i LAKP-së jep përkufizimin dhe afatin kohor për tu njohur Transformimi dhe neni 5.4.1. kërkon "përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi". Por asnjëra nga të dyja dispozitat nuk identifikojnë në mënyrë eksplicite ligjin/ligjet në fuqi për periudhën nga data 22 mars 1989 deri më 12 dhjetor 1999. Për këtë arsye duhet të përdoret teksti nga neni 1 i Rregullores 1999/24.

- Ligji për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore i publikuar në "Gazetën Zyrtare" të RSFJ-së 46/1990. Në këtë ligj duhet të zbatohet teksti i referuar më lartë. Ligji origjinal me të njëjtin titull ishte miratuar nga Kuvendi Federativ i RSFJ-së dhe ishte publikuar në "Gazetën Zyrtare" Federative 84/89. Ky ligj ishte pjesë e grupit të parë të ligjeve të privatizimit në Jugosllavi dhe kishte për qëllim transformimin e pronësisë përmes mjeteve të prodhimit nga shoqëroret në private. Ky ligj – që njihet si Ligji për Kapitalin Shoqëror – u ndryshua dhe plotësua në vitin 1990 dhe versioni i ndryshuar u shpall në "Gazetën Zyrtare" Federative 46/1990. Të dyja versionet, origjinali dhe i ndryshuari, u zbatuan pas afatit të përcaktuar në nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 d.m.th. 22 mars 1989. Megjithatë, ligji përfshinte çështjen lëndore – privatizimin – e cila nuk ishte përfshirë nga ndonjë ligj tjetër i miratuar para datës 22 mars 1989. Përmbajtja e tij nuk është diskriminuese në ndonjë kuptim dhe nuk është në kundërshtim me ndonjë nga instrumentet ligjore ndërkombëtare të përmendura në pikën 1.3 të njëjtit nen. Për këtë arsye dhe në pajtim me pikën 1.2 të të njëjtit nen do të zbatohet i ky ligj.

Megjithatë, ky ligj – që kur u miratua për herë të parë – është ndryshuar më shumë se një herë dhe kjo ngrit çështjen se cili është versioni në fuqi pikërisht për këtë kontest gjyqësor. Në përgjithësi – transformimi i rregulluar me Ligjin për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore ishte proces shumëfazësh që realizohet me veprimet/hapat ligjore pasues. Kështu – në secilin veprim/hap duhet të aplikohen dispozitat e versionit të ligjit në fuqi në kohën kur ka ndodhur ai veprim/hap dhe derisa këto dispozita kalojnë tekstin e Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 nenin 1.2 dhe 1.3.

-Ligji mbi Bankat dhe organizata e tjera financiare (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.10/89 ,40/89, 87/89 dhe 18/90)

- Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligji nr. 04/L-033). Ky ligj i përcakton kompetencat e Dhomës së Posaçme që të vendosë për kontestet e transformimit në lidhje me Ndërmarrjet Shoqërore.

- Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligji nr. 06/L-086). Ky ligj i përcakton po ashtu kompetencat e Dhomës së Posaçme që të vendosë për kontestet e transformimit në lidhje me Ndërmarrjet Shoqërore.

Konstatimet e Kolegjit të Apelit

Transformimi i paraparë me Ligjin për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore të vitit 1990, ishte një proces i veçantë i privatizimit. Qëllimi kryesor ishte të transformohej ekonomia nga ajo me bazë socialiste në atë të tregut. Që të vazhdojë me qasjen shoqërore ligjvënësi në atë kohë ua mundësoi punëtorëve që të blejnë aksione në çmim preferencial dhe me plan të gjatë këstesh.

Këshilli i Punëtorëve i cili ishte organ qeverisës i Ndërmarrjes Shoqërore, kishte kompetenca ekskluzive për të vendosur që të fillohet procesi i privatizimit përmes transformimit. Megjithatë, si palë në privatizim, Këshilli i Punëtorëve nuk ka pasur kompetencë për të vendosur për vlerën e kapitalit të cilën ata kanë dashur ta blejnë përmes shpërndarjes së aksioneve. Për këtë arsye, Ligjvënësi Federativ i ish RSFJ-së e miratoi nenin 4 të Ligjit për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore (Gazeta Zyrtare) e RSFJ-së 46/1990. Sipas kësaj dispozite, Këshilli i Punëtorëve, kur të vendosë për transformimin, do të vazhdojë nga vlera e përlllogaritur e Kapitalit në Pronësi Shoqërore. Kjo vlerë do të krijohet nga organizata e autorizuar me ligj. Kjo organizatë- agjenci, ishte përmendur në nenin 2-a të Ligjit të njëjtë. Agjencia kishte kompetencën për të emëruar një Organ për të ekzekutuar vlerësimin aktual të kapitalit të ndërmarrjes dhe pastaj që ta miratojë atë.

Nga të gjitha vendimet dhe aktet tjera të paraqitura nga ana e paditësit si dëshmi, si dhe nga Aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë për regjistrimin, Fi.597, është e qartë se asnjë vlerësim i tillë i kapitalit shoqëror nuk është paraqitur.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se Vendimet gjyqësore për regjistrimin e këtij entiteti financiar në regjistrat gjyqësor, nuk kanë efekt detyrues dhe mund të kundërshtohen sikurse ka bërë AKP-ja në këtë rast. Vendimi për regjistrim nuk

miraton ndonjë parregullsi që ka ndodhur në procesin e transformimit, pavarësisht nëse gjykata ishte në dijeni për të apo jo.

Çështja e mungesës së vlerësimit të kapitalit shoqëror ishte marrë parasysh edhe nga gjykata e shkallës së I-rë, dhe këtë çështje e kishte ngritur edhe e paditura. Është e qartë se në këtë rast nuk është zbatuar edhe nenet 2-8 i Ligjit për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore, që themelon Agjencinë e specializuar si të vetmin organ kompetent për të bërë vlerësimin e kapitalit.

Për shkak të mungesës së vlerësimit të kapitalit shoqëror i përcaktuar me ligj, të gjitha veprimet që kanë ndodhur në procesin e filluar të transformimit, përfshirë edhe vendimin pasues të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, Aktvendimi nr. Fi597/90, i datës 20.07.1990, për regjistrimin e transformimit, do të konsiderohen pa efekt ligjor.

Kolegji i Apelit konstaton se ky dështim ligjor e përcakton vlefshmërinë e të gjithë procesit të transformimit të NSH-së, Banka Themelore "Bankos", në Shoqëri Aksionare. Transformimi është një proces shumëfazësh ku vlefshmëria e secilit hap përcaktohet gjithashtu edhe nga vlefshmëria e hapave të mëparshëm. Një dështim thelbësor në një fazë e bënë të gjithë procesin të pavlefshëm edhe nëse nuk ka pasur dështime të tjera.

Paditësi në padinë e tij të fundit të dorëzuar me 21 nëntor 2014, ka kërkuar anulimin e vendimit të Bordit të AKP-së të datës 07.05.2014 me të cilën NSH Banka Themelore 'Bankos' është vënë nën likuidim dhe kërkon që ti mbrohen asetet e pretenduara të këtij entiteti bankar, nga shitja që do të bëhet përmes procedurës së likuidimit. Çështja kryesore në këtë lëndë është vërtetimi i faktit se a ka ndodhur një transformim pronësor ligjor dhe jo diskriminues.

Siç ka konstatuar saktë Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS në Aktgjykimin e ankimuar, paditësja ka dështuar të sjellë prova për të vërtetuar se ka qenë i suksesshëm transformimi i NSH Banka Themelore "Bankos" në Shoqëri Aksionare.

Paditësja ka arrite të sjellë disa prova lidhur me procesin e filluar të transformimit për këtë entitet bankar, mirëpo këto prova nuk janë të mjaftueshme dhe nuk vërtetojnë se me sukses është përmbyll i tërë procesi i transformimit.

Kolegji i Apelit vëren se është i bazuar pretendimi AKP-së i dhënë në mbrojtjen në padi, por në procedurën e mëtejme se paditësi nuk ka sjellë as dëshmi të pagesave të aksioneve të brendshme, pastaj mungojnë certifikatat e pagesave të cilat tregojnë emrin e kontribuesit, nuk ka shënime mbi kontabilitetin, gjendjen e bilancit. Për më tepër Kolegji i Apelit vëren se asetet e kësaj Banke aktualisht janë të evidentuara në regjistrat kadastral si pronë shoqërore.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në procedurën ankimore e ka ngritur pohimin se Shkalla e I-rë nuk ka dorëzuar përgjigjen në padi paditësit, dhe sipas tij kështu i ka shkelur rregullat e procedurës të përcaktuara me LDHP-në dhe LPK-në. Kolegji i Apelit e ka pasur në konsideratë këtë pretendim të paditësit mirëpo nuk e konsideron si pretendim të bazuar. Neni 38 i LDHP-së në zbatim ka përcaktuar që përjashtimisht nëse konstatohet se padia apo përgjigja në padi janë jo të plota dhe nevojiten sqarime shtesë, me qëllim të heqjes së këtyre mangësive Gjyqtari i vetëm ose Kryesuesi i Kolegjit, mundet pastaj në afat prej 7 ditësh të dërgon përgjigjen në padi tek pala tjetër. Në këtë rast është e qartë se padia po edhe përgjigja në padi janë vlerësuar si të plota në të cilat janë paraqitur pretendimet e secilës palë mbi kontestin, andaj me të drejtë Gjykata nuk ka vlerësuar të nevojshme dërgimin e përgjegjës në padi për palën paditëse. Për më tepër Kolegji i Apelit vëren se të dy palët në procedurën para Shkallës së I-rë, kanë pas mundësi të plota të paraqesin të gjitha pretendimet qoftë me shkrim apo përmes procedurës gojore, dhe kjo ka ndodhë pasi që si pala paditëse ashtu edhe pala e paditur kanë dorëzuar disa parashtresa në të cilat ata patën mundësi ti paraqesin të gjitha pretendimet që ata i kanë për kontestin. Shkalla e I-rë po ashtu i ka mbajtur dy seanca dëgjimore, ku të dy palëve u ka dhënë mundësi që të deklarohen për çdo pretendim të palës tjetër. Shkalla e I-rë ka shkuar përtej dhe u ka dhënë mundësi të dy palëve që të paraqesin me shkrim edhe fjalët përfundimtare mbi kontestin, dhe këtë mundësi të dy palët e kanë shfrytëzuar, duke i dorëzuar me shkrim fjalën përfundimtare.

Prandaj nga këto arsye nuk mund të pranohet pretendimi i paditësit se atij i është shkelur e drejta për shqyrtim para Gjykatës, apo pretendimi se atij i janë cenuar të drejtat e përcaktuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta dhe Liri të Njeriut.

Tutje Kolegji i Apelit nuk i pranon si të bazuara në ligj as pretendimet që ndërlidhen me meritat e padisë, dhe këtë për të gjitha arsye ligjore që tashmë janë cekur në arsyetimin e këtij Aktgjykimi.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Kthimi i depozitës paditësit

Me pikën 4 të dispozitivit të Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0058 të datës 12 qershor 2015, ishte obliguar paditësi që të deponoj në DHPGJS shumën prej 10.000 euro, për të siguruar kompensimin e shpenzimeve dhe dëmit që mund të pësoj e paditura për shkak të efektit të masës së përkohshme, në rast se nuk del i suksesshëm në meritat e padisë.

Në bazë të provave që ekzistojnë në dosje, paditësi këtë depozitë në shumë prej 10.000 euro e ka paguar me datë 10 korrik 2015, dhe kjo vërtetohet me urdhër pagesën e Raifaisen Bank në Prishtinë, që ekziston në dosje.

Pas marrjes së këtij Aktgjykimi, masa e përkohshme e cila ishte caktuar me Aktvendimin e cekur të Kolegjit të Apelit më nuk do të prodhon efekte ligjore, dhe këtë gjë e ka konstatuar edhe Shkalla e I-rë në pikën 2 të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar.

Në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji i Apelit nuk vëren se AKP-ja si palë e paditur në këtë lëndë, ka kërkuar ndonjë kompensim për shkak masës së sigurisë që ishte vendosur, andaj në mungesë të kësaj kërkesë, Kolegji i Apelit vendos se paditësit duhet ti kthehet shuma e deponuar e depozitës në shumë prej 10.000 euro në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesja tashmë në procedurën ankimore e ka paguar taksën gjyqësore me datë 25 mars 2021, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa gjyqësore shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJS, me datë 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim (përfshirë përkthimin e tij në gjuhën serbe) tek:

- Ankuesja,
- Tek e paditura,
- Shkallës së I-rë të DHPGJS-së në lëndën C-IV-14-7054
- Zyrtares për financa në DHPGJS.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues _____